



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 10636 Prot

Fier më 18/09/2025

PROJEKT VENDIM

NR. 88 dt. 18/09/2025

Për ndreqjen e një gabimi material në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.61 , datë 23/06/2025 , Nr.7329/2 Prot , datë 25/06/2025 « Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për lidhjen e Kontratave para noterit» .

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt.../09/2025, I paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria Juridike për ndreqjen e një gabimi material , në pikën «1» të VKB -së Nr.61 , datë 23/06/2025 , për familjen e shtetasit Tajar Xhevit Toska me numër rendor «3» në tabelën e miratuar , ku gabimisht në të dhënat për strukturën e pasurisë «apartament» është vendosur me përbërje 1+1 dhe jo me përbërje 2+1 sikurse është referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme të lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Fier . Ndreqja e këtij gabimi material kërkohet për vijimin e mëtejshëm të veprimeve administrative ligjore për të cilën është miratuar kërkesa e kësaj familjeje me Vendimin e Këshillit të Bashkisë .

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 97 date 03.02.2008 " Per procedurat e privatizimit te banesave shteterore objekt i ligjit nr. 7652 date 23.12.1992 dhe ligjit nr.9321 date 25.11.2004 " Per trajtimin e banesave dhe objekteve te kthyer ne banesa me fondet e Shoqerive dhe Ndermarrjeve Shteterore " dispozitave ligjore nenet 192,193 të Kodit Civil të Republikës se Shqiperise , si dhe Ligjin Nr.111/ 2018 “ Për Kadastrën “ , ekzekutivi:

Propozon :

1. Të miratojë ndreqjen e një gabimi material , në tabelën e familjeve , pika “1” të Vendimit Nr.61 , datë 23/06/2025, për familjen e shtetasit Tajar Xhevit Toska me numër rendor 3 në lidhje me të dhënë për përbërjen e apartamentit , nga strukturë 1+1 , me strukturë apartamenti 2+1 , sikurse është referuar dokumentacionit kartelë e pasurisë së paluajtshme të lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Fier si dhe në planimetrinë e banesës si më poshtë

Nr.	Emër-Mbiemer	Pasuria / Adresa
3.	Tajar Xhevit Toska	Kartela e Pasurisë së paluajtshme lëshuar nga ASHK, Nr. I pasurisë 6/15 +1-5, Iloji i pasurisë “Apartament “ ZK Nr.8531, Lagjija “11 Janari”, përbërje 2+1 , sip. 73,25 m2

2. Shpenzimet noteriale dhe tarifat për veprimet e regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës , Drejtoria Vendore , do të kryhen nga familjet përfituese;
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier, ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës para noterit publik.

KRYETARI
ARMANDO SUBASHI

NË MUNGESË E ME URDHËR
ZËVËNDËSKRYETAR

Vasil BREGU

